

**AKTI I THEMELIMIT DHE STATUTI  
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR  
“QEHAJ BALDUSHK”  
SH.P.K.**

Në bazë të legjislacionit shqiptar dhe kryesisht në ligjin nr. 7850 datë 29.7.1994 "Për Kodin Civil i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, ligjin nr. 9901 datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, dhe në ligjin nr. 131/2015 "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit" kemi vendosur të hartojmë këtë statut.

Në këtë statut:

- "Ligji" është Ligji Nr. 9901, dt. 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar;
- "Statuti" është Statuti i shoqërisë "QEHAJ BALDUSHK" Sh.P.K..

**KREU I  
EMRI, OBJEKTI, KOHËZGJATJA DHE SELIA**

**Neni 1: Data dhe vendi i themelimit, emri dhe ortaku themelues**

1. Sot, më datë 2.6.2022, në Tiranë, Republika e Shqipërisë, unë themeluesi shtetas shqiptar, me zotësi të plotë për të vepruar, kam krijuar një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin "QEHAJ BALDUSHK" SH.P.K.
2. Ortaku themelues i shoqërisë është:
  - a. Z. Ledian QEHAJ, i lindur më datë 15.11.1991 në Baldushk, Tiranë, Shqipëri, banues në Baldushk, Tiranë, Shqipëri (Albania), i identifikuar me numër personal J11115033U.

**Neni 2: Objekti i veprimtarisë**

Shoqëria tregtare kryen aktivitete të mbarshtimi dhe tregtimi i peshkut, import-eksport dhe ndërmjetësimë tregtare, zyrë shërbimë online, market. Shoqëria tregtare mund të ushtrojë çdo veprimtar, e cila nuk ndalohet me ligj (Neni 7, Ligji nr.9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar).

**Neni 3: Kohëzgjatja**

1. Kohëzgjatja e veprimtarisë së shoqërisë është pa afat.

**Neni 4: Selia ligjore**

1. Selia ligjore e shoqërisë ndodhet në adresën: Baldushk, nr. pasurie 291/151 ZK 2753, Tiranë, Shqipëri (Albania).
2. Adresa e shoqërisë për qëllime komunikimi elektronik është si vijon: [lediangehaj91@gmail.com](mailto:lediangehaj91@gmail.com)

**KREU II  
KAPITALI THEMELTAR DHE FINANCIMI**

**Neni 5: Kapitali themeltar**

1. Kapitali themeltar i shoqërisë është 100.000 Lekë, i nënshkruar, por i pa paguar.
2. Pjesëmarria e themeluesve në kapitalin e shoqërisë është në përputhje me kontributet e tyre të mëposhtme:
  - a. Ortaku themelues, z. Ledian QEHAJ: zotërues i 1 (një) kuote me vlerë të përgjithshme që përben 100 (njëqind) për qind të kapitalit themeltar të shoqërisë, e shprehur në vlerë monetare 100.000 Lekë.

**Neni 6: Zmadhimi dhe zvogëlimi i kapitalit themeltar**

1. Vendimi për rritjen ose zvogëlimin e kapitalit aksionar, në çdo rast dhe në përputhje me ligjin, është kompetencë ekskluzive e ortakëve dhe duhet të miratohet nga ana asamblesë.
2. Kapitali i shoqërisë mund të zmadhohet nëpërmjet nënshkrimeve të pjesëve të kapitalit themeltar për kontributet në para dhe me anë të kontributeve në natyrë, nëpërmjet emërimit nga gjykata kompetente e një eksperti te autorizuar për këto kontribute sipas kërkesës së administratorit të shoqërisë.



3. Në asnje rast shumica nuk mund të detyrojë një ortak për të rritur angazhimin e tij në kapitalin themeltar të shoqërisë.
4. Zvogëlimi i kapitalit lejohet nga Asambleja Përgjithshme e Ortakëve, e cila merr vendim në të njëjtat kushte që kërkohen për ndryshimin e statutit.
5. Në të gjitha rastet, zvogëlimi kapitalit i prek ortakët në të njëjtën masë ndaj pjesëve të kapitalit që përfaqësojnë.
6. Ortakët kanë të drejtë të pajtohen me kuotat e nënshkruara në kohën e rritjes së kapitalit themeltar në proporcione përqindjen e kapitalit të secilit prej tyre respektivisht të mbajtur në datën në të cilën është bërë nënshkrimi.

**Neni 7: Transferimi i kapitalit themeltar**

1. Kuotat e kapitalit të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar "QEHAJ BALDUSHK" Sh.P.K. dhe të drejtat që rrjedhin prej tyre mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:
  - a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
  - b) shitblerjes;
  - c) trashëgimisë;
  - d) dhurimit;
  - e) çdo mënyre tjeter të parashikuar nga ligji në fuqi.
2. Pjesët e kapitalit themeltar janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve.
3. Në rast të vdekjes së një ortaku person fizik, kuota e tij e kapitalit është lirisht e transferueshme në rrugë trashëgimie sipas legjislacionit në fuqi.
4. Ortaku që synon të shes apo të transferoj kuotën e tij të pjesëmarrjes do të duhet t'jua komunikoj këtë ortakëve të tjerë me anë të letrës me postë rekomande të dërguar secilit prej ortakëve; komunikimi duhet të japi të dhënat dhe kushtet e lëshimit të kuotës, dhe veçanërisht, çmimi dhe metoda e pagesës. Ortakët marrës të njoftimit do të jenë në gjendje të ushtrojnë të drejtën e parablerjes duke e bërë ortakun ofrues të parandalojë, me anë letrës me postë rekomande, deklaratën e ushtrimit të parablerjes për blerjen e kuotës pjesëmarrëse jo më vonë se 30 ditë nga data e marries së ofertës që rezulton nga vula postare.
5. Në hipotezën që e të drejtës së parablerjes ushtohet nga ana e shumë ortakëve, pjesa e ofruar i takon ortakëve të interesuar në proporcione me vlerën nominale të pjesëmarrjes së secilit.
6. E drejta e parablerjes duhet të ushtrohet për të gjithë pjesën e ofruar. Nëse asnje nga ortakët nuk dëshiron të blejë pjesën e ofruar, ortaku ofrues mund të konsiderohet i lirë për ta transferuar kuotën që nuk ishte objekt i parablerjes blerësit tjeter jo ortak brenda 30 ditëve nga përfundimi i të drejtës së parablerjes.

**KREU III  
ORGANET VENDIMMARRËSE DHE TË ADMINISTRIMIT**

**Neni 8: Organi vendimmarrës**

1. Asambleja e përgjithshme e ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë.
2. Asambleja e përgjithshme e ortakëve është organi i vetëm vendimmarrës i shoqërisë që miraton çdo ndryshim të statutit sipas modaliteteve të përcaktuara në ligj dhe në statut.
3. Asambleja e përgjithshme e ortakeve është përgjegjëse për marrjen e vendimeve për shoqerinë për çështjet e mëposhtme:
  - a. përcaktimin e politikave tregtare të shoqërisë;
  - b. ndryshimet e statutit;
  - c. emërimin dhe shkarkimin e administratorit ose administratorëve të shoqërisë;
  - d. emërimin dhe shkarkimin e likuiduesve dhe të audituesit ligjor;
  - e. përcaktimin e shpërblimeve për personat e përmendor në shkronjat "c" dhe "d" të kësaj pike;
  - f. mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratori, përfshirë përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
  - g. miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
  - h. zmadhimin dhe zvogëlimin e kapitalit;

- i. pjesëtimin e kuotave dhe anulimin e tyre;
  - j. përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
  - k. riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
  - l. miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
  - m. çështje të tjera të parashikuara nga ligji apo statuti.
4. Ortaku mund të përfaqësohen në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.
  5. Administratori i shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues i ortakëve në asamblenë e përgjithshme të ortakëve.
  6. Autorizimi mund të jepet vetëm për një mbledhje të asamblesë së përgjithshme, e cila përfshin edhe mbledhjet vijuese me të njëjtin rend dite.

#### **Neni 9: Mënyra dhe vendi i thirrjes së asamblesë**

1. Asambleja e përgjithshme e ortakëve thirret nëpërmjet një njoftimi me shkresë dhe/ose me njoftim nëpërmjet postës elektronike të gjithë ortakëve.
2. Njoftimi me shkresë dhe/apo me postë elektronik duhet të përbajë vendin, datën, orën e mbledhjes dhe rendin e ditës e t'u dërgohet të gjithë ortakëve, jo më vonë se 7 (shtatë) ditë përpëra datës së parashikuar për mbledhjen.
3. Kur asambleja e përgjithshme nuk është thirrur sipas pikës 1 të këtij neni, ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse të gjithë ortakët janë dakord, për të marrë vendime, pavarësisht parregullsisë.
4. Asambleja e përgjithshme e ortakëve mund të mblidhet në selinë ligjore ose diku tjetër, për sa kohë që vendi i mbledhjes është në Republikën e Shqipërisë.

#### **Neni 10: Përfaqësimi dhe kuromi**

1. Ortakët mund të përfaqësohen në mbledhje me anë të një prokure ose autorizimi me shkrim të dorëzuar ose transmetuar të autorizuarit, për çdo mbledhje të vetme.
2. Ortakët vendosin mbi çështjet e rezervuara për kompetencë të tyre nga ligji, nga ky statut, dhe për çështjet që një ose më shumë administratorë, ose shumë ortakë që përfaqësojnë të paktën 5 (pesë) për qind të kapitalit themeltar, i paraqesin për miratimin e tyre.
3. Vendimet e ortakëve miratohen gjithmonë me anë të vendimmarres nga ana e asamblesë në përputhje me nenin 90 të ligjit dhe dispozitat e këtij statuti.
4. Në rastin e marres së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme e ortakëve mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zoterojnë më shumë se 51 (pesëdhjetë e një) për qind të kuotave.
5. Në rastin kur asambleja e përgjithshme e ortakëve duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit Nr. 9901, datë 14.4.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm, nëse ortakët që zoterojnë më shumë se 2/3 (dy të tretat) e numrit total të votave, janë të pranishëm personalisht, votojnë me shkresë, apo mjete elektronike, sipas parashikimeve të pikës 3 të nenit 88 të këtij ligji.
6. Nëse asambleja e përgjithshme e ortakëve nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuorimit, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.
7. Të gjithë ata që janë të regjistruar rregullisht në regjistrin tregtar mund të marrin pjesë në mbledhje.

#### **Neni 11: Kryesia e asamblesë**

1. Asambleja drejtohet nga administratori i vetëm, kryetari i këshillit të administrimit ose administratori më i vjetër i moshës (në rastin e emërimit të disa administratorëve me kompetenca të veçanta ose të përbashkëta). Në rast të mungesës ose pamundësës së tyre, asambleja kryesohet nga personi i caktuar nga të pranishmit.
2. Kryetari i asamblesë ndihmohet nga një sekretar i caktuar nga asambleja.
3. Në rastet kur kryetari e konsideron të përshtatshme, funksionet e sekretarit do të kryhen nga një noter.
4. I takon kryetarit të asamblesë të konstatojë formalitetet konstitutive, legjitimitetin e të pranishmëve dhe formalitetet e kryerjes së votimit, duke i raportuar ato në procesverbalin e mbledhjes së asamblesë.

The image shows three handwritten signatures in blue ink, likely belonging to the members of the assembly mentioned in the previous list. The signatures are fluid and vary slightly in style.

5. Mbledhja e asamblesë së ortakëve mund të zhvillohet gjithashtu në disa vende, audio dhe/ose video të lidhura, dhe kjo në kushtet e mëposhtme:
  - a. që kryetari dhe sekretari i mbledhjes të jenë të pranishëm në të njëjtin vend, të cilët do të rregullojnë përgatitjen dhe nënshkrimin e procesverbalit;
  - b. që kryetari i mbledhjes lejohet të konstatojë identitetin dhe legjitimitetin e të pranishmëve, të rregullojë zhvillimin e mbledhjes, të konstatojë dhe të shpallë rezultatet e votimit;
  - c. që të pranishmit të lejohen të marrin pjesë në diskutim dhe votim të njëkohshëm për pikat në rendin e ditës.
  - d. Mbledhja e asamblesë do të konsiderohet e zhvilluar në vendin ku do të jetë i pranishëm kryetari.

#### **Neni 12: E drejta e votës, vendimmarra dhe procesverbal**

1. Secili ortakë ka të drejtë në një numër votash në proporcione me pjesëmarrjen e mbajtura.
2. Asambleja e përgjithshme e ortakëve vendos unanimisht nga mbajtësit e kapitalit themeltar për të ndryshuar statutin, për të rritur ose zvogëluar kapitalin themeltar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe shpërberjen e shoqërisë.
3. Asambleja e përgjithshme e ortakëve vendos me shumicë të thjeshtë për çështje të tjera si:
  - a. përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
  - b. emërimi dhe shkarkimin i administratorëve;
  - c. emërimin dhe shkarkimi i likuiduesve dhe auditorëve ligjorë;
  - d. përcaktimin e shpërblimit për personat e treguar në shkronjat "c" dhe "d" të këtij neni;
  - e. mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshire përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimitarise;
  - f. përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
  - g. miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë.
4. Vendimet e asamblesë duhet të regjistrohen në procesverbal të nënshkruar nga kryetari dhe sekretari.
5. Prosesverbal duhet të tregojë datën e mbledhjes dhe bashkëngjitur identitetin e pjesëmarrësve dhe kapitalin e përfaqësuar nga secili; gjithashtu duhet të tregojë metodat dhe rezultatet e votimit dhe duhet të përbajë, edhe bashkëngjitur, identifikimin e ortakëve në favor, abstinen ose kundër.
6. Prosesverbal duhet të përbledhë, me kërkesë të ortakëve, deklaratën e tyre në lidhje me rendin e ditës.
7. Çdo ndryshim në statut dhe procesverbalet e mbledhjes së asamblesë që me ligj duhet të botohet dërgohen në Qendrën Kombëtare të Biznesit për t'u botuar në regjistrin tregtar, jo më vonë se 30 ditë nga data e procesverbalit, nga ana administratori.


#### **Neni 13: Përashtimi nga e drejta e votës**

1. Ortaku nuk mund të ushtrojë të drejtën e votës nëse asambleja e përgjithshme e ortakëve merr vendim për:
  - a. vlerësimin e veprimitarise së tij;
  - b. shuarjen e ndonjë detyrimi në ngarkim të tij;
  - c. ngritjen e një padie ndaj tij nga shoqëria;
  - d. dhënien ose jo të përfitimeve të reja.
2. Nëse ortaku përfaqësohet nga një përfaqësues i autorizuar, i autorizuari vlerësohet të jetë në të njëjtin konflikt interesit, ashtu si dhe ortaku, të cilin përfaqëson, zbatohet pika 1 e këtij neni.

#### **Neni 14: Administrimi i shoqërisë**

1. Shoqëria mund të administrohet nga një administrator i vetëm, ose nga një këshill i administrimit, ose nga disa administratorë, të cilët mund të veprojnë në një mënyrë kolegiale.
2. Asambleja e përgjithshme e ortakëve emëron një ose më shumë persona fizikë si administratorë të shoqërisë.
3. Emërimi i administratorit prodhon efekte pas regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB).
4. Administratorët qëndrojnë në detyrë deri në largimin apo dorëheqje e tyre, ose për periudhën e përcaktuar nga ortakët në kohën e emërimit të tyre, dhe mund të rizgjidhen.
5. Administratorët mund të mos janë ortakë.

4


6. Administratori i një shoqërie tregtare mëmë, sipas përcaktimit të nenit 207 të këtij ligji, nuk mund të emërohen si administratorë të një shoqërie të kontrolluar e anasjelltas. Çdo emërim i bërë në kundërshtim me këto dispozita është i pavlefshëm.
  7. Emërohet si administrator i parë i shoqërisë, z. Ledian QEHAJ, i lindur më datë 15.11.1991 në Baldushk, Tiranë, Shqipëri, banues në Baldushk, Tiranë, Shqipëri (Albania), i identifikuar me numër personal J11115033U. Afati i emërimit është 5 (pesë) vite, me të drejtë ripërtëritjeje. Firma e depozitar e administratorit
- 

#### **Neni 15 : Kompetencat e administratorit**

1. Organi administrativ administron shoqerinë dhe kryen të gjitha veprimitaritë e nevojshme për të arritur objektin e veprimitarisë së shoqërisë, për aq saç parashikohet me ligj, dhe përveç vendimeve për çështjet e rezervuara për ortakët.
2. Administratori ka të drejtë e detyrohet të:
  - a. kryejnë të gjitha veprimet e administrimit të veprimitarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikat tregtare, të vendosura nga asambleja e përgjithshme e ortakëve;
  - b. përfaqësojnë shoqerinë;
  - c. kujdesen përmajtjen e saktë e të regullit të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
  - d. përgatit dhe nënshkruan bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimitarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përparrë asamblesë së përgjithshme të ortakëve përmiratim;
  - e. krijojnë një sistem paralajmërimi në kohën e duhur përrrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimitarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
  - f. kryejnë regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Biznesit (QKB);
  - g. raportojnë përparrë asamblesë së përgjithshme të ortakëve në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimitarinë e shoqërisë tregtare;
  - h. kryejnë detyra të tjera të përcaktuara në ligj dhe në statut.
3. Administratori është i detyruar të thërrasi Asamblenë e Përgjithshme të Ortakëve, në rastet kur:
  - a. sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton ose ekziston reziku që aktivitet e shoqërisë nuk i mbulojnë detyrimet e kërkueshme brenda 3 (tre) muajve në vazhdim.
  - b. shoqëria propozon të shesë apo të disponojë në mënyrë tjetër aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
  - c. shoqëria, brenda 2 (dy) viteve të para pas regjistrimit të saj, propozon të blejë nga një ortak pasuri, që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.
4. Nëse asambleja e përgjithshme emëron më shumë se një administrator, ata e administrojnë bashkërisht shoqërinë.
5. Asambleja e përgjithshme e Ortakëve mund të lirojë nga detyra administratorin në çdo kohë me shumicë të zakonshme. Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqerinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

#### **Neni 16: Përgjegjësitë e administratorit**

1. Administratori është përgjegjës individualisht, ndaj shoqërisë ose ndaj të tretëve, për shkelje të ligjeve, për shkelje të statutit, apo përfaje të kryera gjatë administrimit të shoqërisë.
2. Pasojat e marrëveshjeve të pa miratuara nga asambleja e përgjithshme e ortakëve që i sjellin dëm shoqërisë, i ngarkohen administratorit dhe ortakut që ka bërë marrëveshjen, për të përballuar në mënyrë individuale ose solidarisht sipas rastit pasojat përkatëse.
3. Përveç sa është parashikuar në dispozitat e përgjithshme të detyrimit të besnikërisë, sipas neneve 14, 15 e 18 të ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", administratori detyrohet:

 5

- a. tē kryejë detyrat e tij te përcaktuara në ligj dhe nē statut nē mirëbesim e nē interesin më tē mirë tē shoqërisë nē tërësi, duke i kushtuar vëmendje tē veçantë ndikimit tē veprimtarisë së shoqërisë nē mjesdis;
  - b. tē ushtrojë kompetencat që i njihen nē ligj dhe nē statut vetëm pér arritjen e qëllimeve tē përcaktuara nē këto dispozita;
  - c. tē vlerësojë me përgjegjësi çështjet, pér tē cilat merret vendim;
  - d. tē parandalojë dhe mënjanojë rastet e konfliktit, prezent apo tē mundshëm, tē interesave personalë me ata tē shoqërisë;
  - e. tē ushtrojë detyrat e tij me profesionalizmin dhe kujdesin e nevojshëm.
4. Administratori, gjatë kryerjes së detyrave të tij, përgjigjet ndaj shoqërisë pér çdo veprim ose mosveprim, që lidhet nē mënyrë tē arsyeshme me qëllimet e shoqërisë tregtare, me përjashtim tē rasteve kur, nē bazë tē hetimit dhe vlerësimit tē informacioneve përkatëse, veprimi ose mosveprimi është kryer nē mirëbesim.
5. Nëse administratori vepron nē kundërshtim me detyrat dhe shkel standartet profesionale, sipas pikave 3 dhe 4 tē këtij neni, është i detyruar t'i dëmshpérblejë shoqërisë dëmet, që rrjedhin nga kryerja e shkeljes, si dhe t'i kalojë çdo fitim personal që ata apo personat e lidhur me ta kanë realizuar nga këto veprime tē parregullta. Administratori ka barrën e provës pér tē vërtetuar kryerjen e detyrave të tij nē mënyrë tē rregulltë e sipas standardeve tē kërkua. Kur shkelja është kryer nga më shumë se një administrator, ata përgjigjen ndaj shoqërisë nē mënyrë solidare.
6. Në mënyrë tē veçantë, por pa u kufizuar nē to, administratori është i detyruar t'i dëmshpérblejë shoqërisë dëmet e shkaktuara, nëse, nē kundërshtim me dispozitat e ligjit "Pér tregtarët dhe shoqëritë tregtare", kryen veprimet e mëposhtme:
- a. u kthen ortakëve kontributet;
  - b. u paguan ortakëve interesa apo dividendë pa vendimmarrjen e asamblesë së përgjithshme tē ortakëve;
  - c. u shpërndan aktivet e shoqërisë;
  - d. lejon që shoqëria tē vazhdojë veprimtarinë tregtare, kur, nē bazë tē gjendjes financiare, duhej tē parashikohej që shoqëria nuk do tē kishte aftësi paguese pér tē shlyer detyrimet;
  - e. jep kredi.

#### KREU IV VITI FINANCIARË

**Neni 17: Viti finanziar dhe audituesi ligjor**

1. Viti finanziar i shoqërisë fillon më datë 1 janar dhe përfundon më datë 31 dhjetor.
2. Përjashtimisht, viti i parë finanziar fillon nga data e regjistrimit tē shoqërisë ne Qendrën Kombëtare të Biznesit dhe mbylljet më datë 31 dhjetor tē po atij viti.
3. Në fund tē çdo viti finanziar, organi administrativ harton draftin e pasqyrave financiare pér vitin me tē gjitha pjesët dhe raportet shoqëruese tē kërkua me ligj, dhe kryen formalitetet pasuese.
4. Asambleja e përgjithshme e ortakëve, me shumicë tē thjeshtë, ka tē drejtë tē emërojë një auditues ligjor pér tē audituar pasqyrat financiare tē shoqërisë.

#### KREU V PRISHJA DHE RIORGANIZIMI I SHOQËRISË

**Neni 18: Prishja dhe likuidimi**

1. Shpëndarja ose prishja e shoqërisë mund tē bëhet nē çdo kohë:
  - a. kur mbaron kohëzgjatja e parashikuar nē statut;
  - b. me vendim tē Asamblesë së Përgjithshme tē Ortakëve;
  - c. me hapjen e procedurave tē falimentimit;
  - d. nëse nuk ka kryer veprimtar tregtare pér dy vjet dhe nuk është njoftuar pezullimi i veprimtarisë;

- e. me vendim të gjykatës.
- 2. Ne këtë rast ortakët marrin vendim me shkrim në të cilin parashikojnë mënyrën e likuidimit të shoqërisë, duke caktuar një apo disa likuidatorë dhe duke shënuar në çdo dokument të nxjerre prej tij emrin e likuidatorit dhe emërtesën shtese "Shoqëri ne likuidim e sipër".
- 3. Prishja e shoqërive tregtare ka si pasojë hapjen e procedurave të likuidimit në gjendjen e aftësisë paguese, me përjashtim të rasteve kur është nisur një procedurë falimentimi.
- 4. Likuidimi kryhet nga likuiduesit e emëruar nga ortakët.
- 5. Nëse ortakët nuk marrin një vendim për emërimin e likuiduesve, brenda 30 ditëve pas prishjes, çdo person i interesuar mund t'i drejtohet gjykatës përkatëse, për të caktuar një likuidues.

#### **Neni 19: Rioranizimi i shoqërisë bashkimi dhe ndarja e saj**

1. Shoqëria mund të ndahet ose bashkohet sipas vendimit të mbledhjes të Asamblesë së Përgjegjshme të Ortakëve, në përputhje me dispozitat ligjore të parashikuara në pjesën IX-të të ligjit Nr.9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar.

#### **Neni 20: Baza ligjore**

1. Shoqëria do te zhvilloje aktivitetin e saj në përputhje të plotë me këtë statut dhe dispozitat e legjislacionit shqiptar.
2. Për sa nuk parashikohet në këtë statut, do te zbatohen dispozitat e Nr.9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", Kodit Civil dhe çfarëdo ligji tjetër specifik ne Republikën e Shqipërisë.

#### **Neni 21: Mosmarrëveshjet**

1. Për mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me zbatimin apo interpretimin e këtij statuti, si dhe për çdo mosmarrëveshje që mund të lindë midis shoqërisë dhe të tretëve, do të jetë kompetente gjykata shqiptare në të cilën ka vendndodhjen shoqëria. Në këtë rast Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

### **KREU VI DISPOZITAT TË VEÇANTA**

#### **Neni 22: Dokumentet**

1. Ky statut është hartuar në dy (dy) kopje origjinale me vlerë të njëjtë ligjore në gjuhën shqipe.
2. Të gjitha dokumentet e lëshuara nga shoqëria do të përbajnjë emërtimin e shoqërisë "QEHAJ BALDUSHK" Sh.P.K., NIPT/NUIS dhe adresën e selisë ligjore, vulën dhe firmën e administratorit.
3. Administratori mban një regjistrë të protokollit. Çdo dokument me vlerë ligjore i lëshuar/i pranuar nga ana e shoqërisë regjistrohet në regjistrin e protokollit nga ana e administratorit.

#### **Neni 23: Baza ligjore**

1. Për çështje të tillë që nuk parashikohen në këtë statut, veprimtaria e shoqërisë do të bazohet në legjislacionin shqiptar në fuqi.

**ORTAKU**

**I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR**

"**QEHAJ BALDUSHK**"

SH.P.K.

Z. Ledian QEHAJ

